




<b>REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	
Dep.	
Dep.	<u>2-D /DPK</u>
Nr. i lloji	
Broj stranica	<u>03</u>
Nr. pages	
Nr. Prot.	<u>01-2101/2012</u>
E-mail	
Dati	<u>13.06.2012</u>
Datum	
Dati	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 05.06.2012, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I.** Mbylltet rasti me nr.AKK- 03-5098/11,për Zyrtarin e Lartë z. Shkumbin Kastrati, ud.i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne Ministrin e Punëve të Brendshme, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I.** Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 te ligjit Nr.04/L-051,Per Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marre gjate kontrollit te formularit për deklarim te pasurisë, ka filluar shqyrtimi i lended me numër protokolli AKK-03-5098/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Shkumbin Kastrati, u.d.i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne Ministrin e Punëve të Brendshme.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, u.d.i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne Ministrin e Punëve të Brendshme, ka qene i regjistruar ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve ARBK, si pronar dhe person i autorizuar ne biznesin , N.T.P. "Ledianë" ne Gjakovë, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupcionit me datën 27.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit

të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Shkumbin Kastrati, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar te ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia.

Me datën 12.04.2012 është mbajtur takimi me, z.Shkumbin Kastrati, ne zyrat e AKK-së, gjate takimit, është biseduar për gjendjen dhe faktet qe disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z.Shkumbin Kastrati, gjatë takimit është pajtuar për situatën miro po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për ketë, pasi qe nuk e ka informuar as kush qe nga momenti i i emërimit si. u.d. i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne Ministrin e Punëve të Brendshme.

Zyrtari i Lartë, z.Shkumbin Kastrati pas pyetjeve qe i kane ber zyrtarët e AKK-ë, është përgjigjur duke shpjeguar se biznesin privat qe e ka, mendon se nuk ka asnjë lidhshmëri me funksionin publik, dhe nuk ka pas njohuri për ketë situatë qe mundë te shkaktoj Konflikt te mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtaret e AKK-së, e kanë njoftuar z.Kastratin për situatën e cila paraqet mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik te paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

z. Shkumbin Kastrati, është zotuar se ne afatin ligjor do te bçj ndryshimet ne ketë biznes, ose do te largohet nga funksioni menaxhues si u.d. i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile.

Me datën 22.05.2012, zyrtari z. Shkumbin Kastrati , ka dërguar një shkresë ku e njofton AKK-në se ka paraqitur kërkesën e tij për dorëheqje pran Kryeshefit Ekzekutiv te ARC-së z.Blerim Camaj, dhe Sekretarit te përgjithshme te MPB, z.Ilhami Gashi.

Po ashtu Agjencia kundër Korrupsionit është njoftuar nëpërmes pikes kontaktuese ne MPB nga znj.Vjollca Bruqi se z.Shkumbin Kastrati ka dhënë dorëheqje nga pozita u.d. i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne MPB, kurse ne vendin e tij është caktuar znj.Sabrie Rashani si u.d. i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile.

Andaj ne baze dëshmive dhe te dhënavë për zyrtarin e larte konstatojmë se:

z. Shkumbin Kastrati, u.d. i Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne Ministrin e Punëve të Brendshme ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit te interesit ne te cilën ndodhej, pasi qe nuk mbanë me pozitën e u.d. te Drejtorit të Departamentit të Regjistrimit të Gjendjes Civile ne Ministrin e Punëve të Brendshme. Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri me funksionin publik si u.d.i Drejtorit te Departamentit dhe funksionit si personi autorizuar dhe pronarë ne biznesin e tij Privat N.T.P.”Ledianë” ne Gjakovë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)



Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit